

KPK konfirmon në detyrë prokuroren Anisa Qilimi

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmoi të martën në detyrë prokuroren e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Anisa Qilimi.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Prokurorja Anisa Qilimi | Foto Edmodn Hoxhaj

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpalli të martën në mëngjes vendimin për konfirmimin në detyrë të prokurores, Anisa Qilimi. Gjithashtu, KPK vendosi t'i transferonte për inspektim në Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë, 2 çështje të hetuara nga prokurorja e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Trupa gjyqësore që po kryen procesin e vetingut përbëhet nga Etleda. Çiftja kryesuese, Xhensila Pine relatores dhe Pamela Qirko anëtare. Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar ishte e pranishme Elka Ermenkova.

Anisa Qilimi ka përfunduar studimet e Shkollës së Magjistraturës në vitin 2007 dhe është emëruar prokurore në Prokurorinë e Krujës. Prej vitit 2014, ajo punon si prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



RRETH AUTORIT

Edmond Hoxhaj

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.